

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare Avdi Dinaj dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve: A. R.1 dhe A. R.2 që të dy nga Komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga i dënuari A. R.2, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, P.nr.282/2013 datë 30.5.2014 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PA 1 nr.1086/2014 datë 28.1.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14 prill 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit A. R.2, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, P.nr.282/2013 datë 30.5.2014 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PA 1 nr.1086/2014 datë 28.1.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, P.nr.282/2013 datë 30.5.2014 të dënuarit A.R.1 dhe A. R.2 janë shpallur fajtorë për veprën penale vjedhje e rëndë

në bashkëkryerje nga neni 327 par. 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPK dhe për këto vepra penale i është shqiptuar dënimi i kushtëzuar, me të cilin secilit prej të dënuarit i është caktuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muajsh, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse të dënuarit brenda 3 vitesh nuk kryejn vepër të re penale, e me të cilin dënim të dënuarve i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 23.3.2013 gjer më 23.4.2013 dhe me dënim me gjobë, i dënuari A. R.1 në shumë prej 800 €, të cilën shumë është e detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast mospagese e njëjta do t'i zëvendësohet me dënim burgu, ku për çdo 20 € të filluar do t'i llogaritet një ditë burgim, ndërsa i dënuari A. R.2 është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 €, të cilën është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast mospagese e njëjta do t'i zëvendësohet me dënim burgu, ku për çdo 20 € të filluar do t'i llogaritet një ditë burgim. Të dënuarit janë të detyruar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës e në mënyrë solidare, kurse secili prej tyre shumën prej nga 40 € në emër të paushallit gjyqësor.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Prishtinë, PA 1 nr. 1086/2014 datë 28 janar 2016.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari A. R.2 pa i përcaktuar bazat e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr.54/2016 datë 21.3.2016 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitave të nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, e cila nuk përmban bazat e kërkesës, thekson se në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë, ndërsa e tërë

kërkesa është e drejtuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se është takuar ditën kritike me të dënuarin A.1 në orët e pasdites, ndërsa rreth orës 19 i njëjti i kishte thënë “A po mi strehon këto sende, se i kam marrë në punë” e që ishin një motor i druve i tipit “...” , dy hilta dhe një brusalicë dhe disa gjëra tjera, duke iu arsyetuar se nuk guxon t’i dërgojë në shtëpi, për të cilat gjëra më vonë ka kuptuar se janë vjedhur nga shtëpia e të dëmtuarit I. R.. Thekson se të njëjtat gjëra i ka fshehur në oborrin e shtëpisë së braktisur të B. R. dhe atë në kotecin e pulave.

Nga shkresat e çështjes rrjedh se shtëpia e të dëmtuarit I. R.-dera e bodrumit është thyer me një mjet të përshtatshëm, me ç’rast janë vjedhur dy hilta, një motor share e markës “Shtill” dhe një brusalicë, të cilat sende janë fshehur në kotecin e pulave në shtëpinë e braktisur të B. R. Nuk janë kontestuese se sendet e vjedhura i janë kthyer të dëmtuarit.

Po ashtu, nuk janë kontestuese rrethanat se të dënuarit së bashku gjësendet e vjedhura nga shtëpia e të dëmtuarit i kanë fshehur në kotecin e pulave, duke e thyer derën e saj i vendosin sendet e vjedhura, mbyllin derën dhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Mirëpo, duhet theksuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet për shkak të shkeljes së Ligjit penal, në rastet e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale apo të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor konform dispozitës së nenit 432 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPK-së , ndërsa konform par. 2 të të njëjtës dispozitë ligjore, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Po ashtu, duhet theksuar se konform dispozitës së nenit 436 par. 1 të KPPK-së, Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kufizohet vetëm në veprimin e shkeljeve ligjore për të cilat paraqitësi pretendon në kërkesë.

Nga arsyet e dhëna më sipër, kjo Gjykatë refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

PML.nr.80/2016 datë 14.4.2016

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa